

VENDIM
Nr. 203, datë 7.4.2023

**PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT DHE FILLIMIN E APLIKIMIT TË REGJIMIT
TË VEÇANTË PËR BURSËN SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 155/3, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është parashikimi i procedurave të zbatimit dhe fillimit të aplikimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

2. Tregtimi i energjisë elektrike në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike kryhet në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregtimit, miratuar me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike”.

3. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në rolin e saj si kundërpalë qendrore, vendoset ndërmjet transaksioneve të palëve brenda tregut të energjisë elektrike dhe merr rolin e blerësit kundrejt kundërpalës shitëse dhe rolin e shitësit kundrejt kundërpalës blerëse me qëllim garantimin e transaksioneve.

4. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, sipas modelit të tregtimit të energjisë elektrike, nuk kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtari të shitblerjes së energjisë elektrike, por ofron shërbimin e administrimit e të garantimit të kësaj veprimtarie, nëpërmjet platformës së tregtimit, klerimit dhe shlyerjes, si kundërpalë qendrore. Duke pasur këtë rol për të gjitha transaksionet që kryhen në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, si në blerje ashtu edhe në shitje të energjisë elektrike, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka edhe përgjegjësinë e lëshimit të faturës, si për blerësin ashtu edhe për shitësin e energjisë elektrike.

5. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike përgatit një faturë tatimore për kundërpalën blerëse dhe një faturë tatimore për kundërpalën shitëse, të cilat rezultojnë fitues nga urdhërporositë e vendosura në platformën e tregut dhe në transaksione të përmbyllura, si më poshtë vijon:

a) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lëshon një faturë tatimore për anëtarin e saj që nga transaksionet e përmbyllura gëzon pozicionin e blerësit të energjisë elektrike, e cila do të jetë me TVSH të përjashtuar.

b) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lëshon një faturë tatimore, në emër të anëtarit të saj, i cili nga transaksionet e përmbyllura gëzon pozicionin e shitësit të energjisë elektrike. Kjo faturë do të jetë me TVSH të përjashtuar, duke zbatuar përcaktimet e nenit 100, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Mënyra e faturimit dhe qëllimet e përdorimit të energjisë elektrike të blerë nga anëtari fitues në pozicionin e blerësit të energjisë elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike kryhen, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike e përdor atë për nevojat e veta, duke mos pasur si qëllim që ta rishesë, ai përgatit një faturë tatimore, në të cilën është edhe në pozicionin e shitësit edhe në pozicionin e blerësit. Ky furnizim do t’i nënshtrohet normës standarde 20% të TVSH-së.

b) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike ia furnizon energjinë elektrike një personi të tatueshëm brenda vendit, faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në legjislacionin në fuqi

për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Ky furnizim do t'i nënshtrohet normës standarde 20% të TVSH-së.

c) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike ia furnizon energjinë elektrike një personi të tatueshëm jashtë Republikës së Shqipërisë, faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Ky furnizim eksporti do të trajtohet me shkallë 0% të TVSH-së.

7. Aplikimi i regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama